

URDHËR
Nr. 192, datë 13.5.2015

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË
DREJTAT E AUTOREVE NË FUSHËN E KINEMATOGRAFISË DHE TË VEPRAVE
TË TJERA AUDIOVIZUALE “FMAA”**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 446 prot., datë 4.5.2015, të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të drejtat e autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës, miratimi i dhënies së licencës kësaj Agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3, të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të drejtat e autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale “FMAA”.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi